

|   |  |                     |
|---|--|---------------------|
|  | <b>KOMENTE NE RAPORTIN<br/>KONSULTATIV</b> | <b>FO-ÇLRR-025</b>  |
|   | <i>ver. 1.0</i>                            | <i>fage 1 nga 4</i> |

**08 prill 2011**

**Komente ndaj Raportit Konsultativ të ZRrE për Tarifën e Rregulluar 220kV**

|   |  |                     |
|---|--|---------------------|
|  | <b>KOMENTE NE RAPORTIN<br/>KONSULTATIV</b> | <b>FO-ÇLRR-025</b>  |
|   | <i>ver. 1.0</i>                            | <i>faqe 2 nga 4</i> |

KOSTT me datë 04.04.2011 ka pranuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji Raportin Konsultativ lidhur me tarifën e rregulluar për shërbim me energji elektrike në nivelin 220kV.

Në vazhdim KOSTT paraqet komentet ndaj këtij Raporti.

### 1.

- Për hir të korrektësisë dhe evitimit të konfuzionit KOSTT kërkon që termi gjuhësor “kërkesë” të zëvendësohet me termin “fuqi” i cili përdoret në Raport pra të bëhet dallimi në mes të parashikimit të fuqisë dhe kërkesës për energji.

Gjysma e të hyrave duhet të mblidhet përmes tarifës së kërkesës (kW). Kjo tarifë do të bazohet në kërkesën e parashikuar (ose "kontratës") së Ferronikelit dhe jo në kërkesën faktike...

### 2.

- Sipas këtij Raporti ZRrE propozon që për përcaktimin e tarifës së rregulluar për konsumatorët 220 kV, humbjet në transmision për vitin 2011 të llogariten 2.3%. Më tej ZRrE propozon që ky nivel i humbjeve të ndahet në dy nivele të tensionit, përkatësisht në nivelin 110 kV humbjet të llogariten 1% kurse në nivelin 220 kV 1.3%.
- **KOSTT dëshiron të dijë se në baze të çfarë metodologjie është përcaktuar ndarja e humbjeve në mes të nivelit 110 kV dhe 220 kV në mënyrë që eventualisht të kontribuojmë me ekspertizën që KOSTT-i ka për këtë çështje?**

*Aplikacioni i KEK-ut i supozon humbjet totale të transmisionit prej 3.1%, në përputhje me humbjet e lejuara të ZRRE-së në 2010. Nga kjo, KEK-u ka zbritur humbjet e vlerësuara paraprakisht të transmisionit në nivelin 110kV në 1.5%, për të dhënë humbjet e vlerësuara paraprakisht të transmisionit në nivelin 220 kV në 1.6%. Për vitin 2011, ZRRE-ja propozon të lejojë humbjet e transmisionit në 2.3%. ZRRE-ja propozon që, në përcaktimin e tarifës së rregulluar për konsumatorët 220kV, të zbresë 1% nga ky nivel i lejuar për të dhënë humbjet e vlerësuara paraprakisht të transmisionit në nivelin 220 kV në 1.3%. Kjo do të rrisë në masë të vogël tarifën mesatare në raport me atë të projektuar nga KEK-u.*

### 3.

- KEK supozon se për të gjitha tarifat e aplikuara nga KOSTT do të jetë përgjegjës Ferronikeli të cilat do të paguhen nga KEK.  
Në bazë të Legjislacionit në fuqi, përkatësisht Rregullave të Tregut furnizuesi është përgjegjës për të gjitha obligimet ndaj transmisionit e jo Ferronikeli shih si vijon: RR.T. neni 58.5 **“OT do t’i faturojë secilës Palë Tregtare relevante një herë në muaj një Tarifë të Rrjetit të Transmisionit për Furnizuesin.....”**, ku sipas RR.T. Pala Tregtare definohet kështu: **“Pala Tregtare” – është Gjenerator, Furnizues, Tregtarë Interkonektiv ose palë tjetër e cila ka aderuar në RRT që Tregtojnë Energjinë.**  
Pra, në bazë të legjislacionit përgjegjësinë për tarifat e aplikuara nga KOSTT e bart KEK-u, deri në momentin që Ferronikeli të arrijë statusin e Palës Tregtare.
- Ndërsa obligimet e Ferronikelit janë ato obligime që dalin nga Marrëveshja e Kyçjes, të cilën konsumatorët e privilegjuar në këtë rast Ferronikeli është i obliguar ta nënshkruajë me KOSTT në bazë të:
  - Rregullit të përgjithshëm për Furnizim me Energji respektivisht neni 4.1 ku thuhet: **“Në përputhje me dispozitat e këtij Rregulli, të gjithë konsumatorët kanë të drejtën dhe detyrimin që të: a) kërkojnë kyçe të objekteve dhe paisjeve të tyre energjetike në rrjetin e operatorit të sistemit...”**, përkufizimet – **“Marrëveshje për kyçe – nënkupton marrëveshjen ndërmjet operatorëve të sistemit dhe shfrytëzuesve të sistemit, që përsbëruan procedurat e kyçjes, fillimit, mirëmbajtjes dhe përfundimit të kyçjes në sistem.”**
  - Ligjit për Energjinë Elektrike – përkufizimet - **“Shfrytëzuesit e sistemit” do të thotë personat fizikë dhe juridikë që e furnizojnë ose furnizohen nga një sistem i transmisionit ose shpërndarjes;**
  - Kodi i Kyçjes – Kodi i Rrjetit – **1.1.1.1 Afatet dhe kushtet në të cilat lejohet kyçja në Sistemin e Transmisionit do të vendosen në një marrëveshje komerciale, në afate të arsyeshme, mes përdoruesit dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (OSTT). Kjo gjithashtu qubet edhe marrëveshja e kyçjes (MK) dhe është një marrëveshje e veçantë kontraktuale mes OSTT dhe përdoruesit për secilën pikë individuale të kyçjes të Sistemit të Transmisionit...; 5.1.1.1 OSTT duhet të ofrojë lidhjen e një marrëveshjeje të kyçjes me kategori të ndryshme përdoruesish duke in referuar: 1. vendeve të reja të kyçjes; 2. vendeve ekzistuese të kyçjes; dhe 3. modifikimeve të një vendi të kyçjes;**
- Prandaj Ferronikeli duhet ta nënshkruaj Marrëveshjen e Kyçjes me KOSTT-in meqenëse në pikën e kyçjes subjektet juridike janë vetëm Ferronikeli dhe KOSTT dhe duhet të rregullojnë marrëdhëniet e mirëmbajtjes, kapacitetin e transferimit etj.

*Aplikacioni i KEK-ut supozon se Ferronikeli do të jetë përgjegjës për të gjitha tarifat e shrytëzimit të sistemit të transmisionit (SHST) të aplikuara nga KOSTT-i, të cilat KEK-u do t’i paguajë në emër të Ferronikelit. Meqë Ferronikeli është i kyçur në nivel të tensionit prej 220 kV, nuk do të jetë përgjegjës për tarifat SHST që lidhen me shfrytëzimin e rrjetit të transmisionit 110kV. Në përcaktimin e tarifës së rregulluar për konsumatorët 220kV, ZRRE-ja propozon që të zbrisë taksat SHST të*

|   |  |                     |
|---|--|---------------------|
|  | <b>KOMENTE NE RAPORTIN<br/>KONSULTATIV</b> | <b>FO-ÇLRR-025</b>  |
|   | <i>ver. 1.0</i>                            | <i>faqe 4 nga 4</i> |

*aplikueshme për konsumatorët kyçur në nivelin 110kV. Kjo do të zvogëlojë në masë të vogël tarifën mesatare në raport me atë të projektuar nga KEK-u.*

4.

- Duke marrë parasysh se tarifat për ngarkesa dhe shfrytëzimin e rrjetit të transmisionit për vitin 2011 ende nuk janë vendosur, **KOSTT kërkon që të njoftohet se cilat tarifa të transmisionit janë përdorur për llogaritjen e tarifës së rregulluar 220 kV, si dhe të qartësohet se me cilat tarifa KOSTT do ta ngarkojë furnizuesin në këtë rast?**  
Që të eliminohet çfarëdo konfuzioni KOSTT propozon që në vendimin e ZRRE-së kjo çështje të mos mbetet e pa sqaruar.

Fundi i Dokumentit